



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

420/20

Data/Datum.

28.07.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PRISHTINË - PRISHTINA

PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.420/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues dhe z. Goran Milenković – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Lulzim Katanolli” B.I. - Prishtinë, kundër vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi në objektet shëndetësore” me nr. prok: 616-20-1192-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën 27.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET, si e pa bazuar ankesa e operatorit “Lulzim Katanolli” B.I., - Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi në objektet shëndetësore” me nr. prok: 616-20-1192-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi në objektet shëndetësore” me Nr. prok: 616-20-1192-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik “Lulzim Katanolli” B.I-Prishtinë, refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Lulzim Katanolli” B.I-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 25.06.2020, me nr. 420/20, kundër vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi në objektet shëndetësore” me Nr. prok: 616-20-1192-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -Kuvendi Komunal Prishtinë.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 54, 59, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.07.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues / teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues dhe ai teknik i prokurimit në raportin e dt: 13.07.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqarojnë si në vijim: AK përmes dosjes së tenderit (Aneksi 1 specifikimet teknike të detyrueshme, tek Dezinfektimi) kërkon që:

- Për kryerjen e këtij aktiviteti duhet të përdoren preparatet dezinfektuese të spektrit të gjerë të veprimit si jo irrituese dhe jo koroduese si në bazë të :
 - H₂O₂ (peroksidit të hidrogjenit),
 - Komponimet aktive të amoniumit,
 - Hipoklorit natriumi.

Eksperti teknik-shqyrtues vërteton që OE “Lulzim Katanolli B.I” –Prishtinë, nuk ka ofruar preparate me bazë Hipoklorit natriumi ashtu siç kërkohet në Specifikimet Teknike të Detyrueshme, madje e pranon edhe vet në letërën sqaruese ku thotë se: andaj, si Epidemiolog dhe njohës i fushës së DDD-së, qëllimi ynë ka qenë që ky produkt të mos përdoret. Shih përgjigjen më poshtë:

Me qenë se prioriteti ynë gjatë aplikimit të dezinficienteve është mbrojtja e stafit shëndetësor, pacienteve dhe ambientit, hapësirave punuese brenda institucioneve shëndetësorë, me keqardhje duhet të ceket se në specifikimin teknik, nuk është dashur të kërkohen produktet në bazë të Hipoklorit Natriumit, për shkak se po bie ndesh me kërkesën e specifikimit teknik. Arsyeja është:

- Hipoklorit Natriumi (zbardhues) nuk është preparat dezinfektues i spektrit të gjerë.
- Ekspozimi ndaj solucioneve të zbutura të hipoklorid natriumit shpesh shkaktojnë irrim, skuqje, dhimbje dhe tharje si dhe qarje të lëkurës.
- Gjatë aplikimit të solucionit evaporon dhe liron gazra toksike që shkaktojnë: Irritim të mukozës së syve, të traktit respirator dhe digjektiv.
- Është preparat korodues (Dëmton sipërfaqet punuese, posaçërisht ato metalike, pllakat, parketin, etj.)

Hipoklorit Natriumi përdoret si zbardhues, mund të përdoret nëpër hapësira të jashtme dhe trajtim të ujit.

Si rezultat i këtyre vetive, nuk është dashur të jetë fare në specifikimin teknik.

Andaj, si Epidemiolog dhe njohës i fushës së DDD-së, qëllimi ynë ka qenë që ky produkt të mos përdoret.

Eksperti teknik-shqyrtues i kualifikon si të pa bazuara pretendimet ankimore të OE “LULZIM KATANOLLI” B.I. – Prishtinë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues/teknik; Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertet i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Me datën 13.07.2020 janë njoftuar palët me raportin e eksperteve shqyrtues përkatësisht teknik të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues, me datën 13.07.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik të prokurimit.

Operatori Ekonomik me datën 16.07.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik të prokurimit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues “Lulzim Katanolli” B.I. - Prishtinë, se është eliminuar nga autoriteti kontraktues pa të drejtë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik sqaron se autoriteti kontraktues përmes dosjes së tenderit (Aneksi 1 specifikimet teknike të detyrueshme, tek Dezinfektimi) kërkon që:

- Për kryerjen e këtij aktiviteti duhet të përdoren preparatet dezinfektuese të spektrit të gjerë të veprimit si jo irrituese dhe jo koroduese, si në bazë të:
 - H₂O₂ (peroksidit të hidrogjenit),
 - Komponimet aktive të amoniumit,
 - Hipoklorit natriumi.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik konstaton se operatori ekonomik ankues “Lulzim Katanolli B.I” –Prishtinë, nuk ka ofruar preparate me bazë Hipoklorit natriumi ashtu siç kërkohet në

Specifikimet Teknike të Detyrueshme, madje e pranon edhe vet në letrën sqaruese ku thotë se: andaj, si Epidemiolog dhe njohës i fushës së DDD-së, qëllimi ynë ka qenë që ky produkt të mos përdoret. Shih përgjigjen me poshtë: Me qenë se prioriteti ynë gjatë aplikimit të dezinficenteve është mbrojtja e stafit shëndetësor, pacienteve dhe ambientit, hapësirave punuese brenda institucioneve shëndetësore, me keqardhje duhet të ceket se në specifikimin teknik nuk është dashur të kërkohen produktet në baze të Hipoklorit Natriumit, për shkak se po bie ndesh me kërkesën e specifikimit teknik. Arsyeja është: - Hipoklorit Natriumi (zbardhues) nuk është preparat dezinfektues i spektrit të gjere. Ekspozimi ndaj solucioneve të zbutura të hipoklorid natriumit shpesh shkaktojnë iritrim, skuqje, dhimbje dhe tharje si dhe qarje të lëkurës. Gjatë aplikimit të solucionit evaporon dhe liron gazra toksike që shkaktojnë: Iritrim të mukozës së syve, të traktit respirator dhe digjektiv. Është preparat korodues (Dëmton sipërfaqet punuese, posaçërisht ato metalike, pllakat, parketin, etj.) Hipoklorit Natriumi përdoret si zbardhues, mund të përdoret nëpër hapësira të jashtme dhe trajtim të ujit. Si rezultat i këtyre vetive, nuk është dashur të jetë fare në specifikimin teknik. Andaj, si Epidemiolog dhe njohës i fushës së DDD-së, qëllimi ynë ka qenë që ky produkt të mos përdoret. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues/teknik i kualifikon si të pa bazuara pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues “Lulzim Katanolli” B.I. – Prishtinë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit të ofertave ka vlerësuar drejtë ofertat e operatoreve ekonomik për shkak se OE ankues nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, konkretisht nuk i përmbush specifikimet teknike të detyrueshme të Aneksit 1, ashtu siç ka kërkuar autoriteti kontraktues në njoftimin për kontratë. Andaj, anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë konform nenit 62 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Kuvendi Komunal Prishtinë

1x1 OE ankues – “Lulzim Katanolli B.I -Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi